

KUSHTET E SIGURIMIT TË VETË MJETIT MOTORIK (KASKO)

Në bazë të kontratës ndërmjet palëve **INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP** do të dëmshpërbleje për dëmet e ndodhura në mjetin motorik në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale, në përputhje me kushtet e kontratës, brenda periudhës së sigurimit dhe në territorin e përcaktuar në kontratë.

1. Terma të Përgjithshëm

- 1.1 **Siguruesi** kupton **INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP**, që lëshon këtë kontratë.
- 1.2 **I Siguruari** kupton personin fizik ose juridik, interesi i të cilit mbrohet nga sigurimi.
- 1.3 **Përfaqësuesi ose Kontraktuesi** kupton personin fizik ose juridik që kryen veprime dhe nënshkruan kontratën e sigurimit për llogari dhe në emër të të Siguararit/ve.
- 1.4 **Mjet Motorik** kupton një mjet që lëviz në tokë, por jo mbi shina, me anë të fuqisë motorike, pavarësisht nga numri i rrotave. Mjete motorike do të quhen edhe rimorkiot ose gjysëm rimorkiot, pavarësisht nëse janë të bashkuara apo jo me mjetin motorik tërheqës.
- 1.5 **Përdoruesit** kupton personat që përdorin mjetin motorik të siguruar, emrat e të cilëve shënohen detyrimisht në kontratën e sigurimit dhe për të cilët është i vlefshëm mbulimi në rast sigurimi. I siguruari, në rastin e një subjekti, duhet të pajisë me autorizim me shkrim të gjithë përdoruesit e mjetit dhe të dorëzojë listën me emra tek Siguruesi. Në një ngjarje sigurimi, autorizimi do të jetë i vlefshëm vetëm nëse përdoruesi do të paraqesë autorizimin me shkrim datuar përpara ngjarjes së sigurimit, të cilën e ka depozituar tek siguruesi.
- 1.6 **Kontrata** është marrëveshja me shkrim midis Siguruesit dhe të Siguararit. Pjesë e kontratës së sigurimit janë edhe Polica e Sigurimit, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Pyetësorët, Fotot e Marrjes në Sigurim.
- 1.7 **Kushtet e Përgjithshme të Kontratës**, nënkuptojnë kushtet e kontratës për sigurimin Kasko të mjeteve motorike të përgatitura nga Siguruesi dhe të dakortësuar nga i Siguruari që kanë efekt me pranimin dhe firmosjen nga palët të policës së sigurimit. Dakortësimi me kushtet e Sigurimit mund të jetë me shkrim apo me pranimin e policës së sigurimit.
- 1.8 **Rrugë** konsiderohet zona për përdorim publik e destinuar për qarkullimin e mjeteve. Në zbatim të Kodit Rrugor, rrugët klasifikohen në autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane kryesore, rrugë urbane dytësore dhe rrugë lokale.

2. Periudha e Sigurimit

Kjo kontratë vlen vetëm për dëmet që ndodhin gjatë periudhës së treguar në Kontratën e Sigurimit. Periudha e sigurimit si rregull është një vjeçare, përveç rasteve kur në Kontratën e Sigurimit përcaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj. Kontrata e Sigurimit nuk rinovohet me heshtje. Mbulimi në sigurim, hyn në fuqi në orën 24.00 të datës së përcaktuar si datë fillimi në kontratë dhe përfundon në orën 24.00 të datës së përcaktuar si datë mbarimi të mbulimit në sigurimin në Policën e Sigurimit.

3. Shtrirja Territoriale

Kjo kontratë vlen për dëmet që ndodhin në territorin e Shqipërisë, siç është përcaktuar në Policën e Sigurimit. Zgjerimi i territorit të mbulimit bëhet për raste të veçanta dhe përcaktohet në Policë e sigurimit kundrejt pagesës së primit shtesë. Zgjerimi i shtrirjes territoriale do të përfshijë kontinentin Europian dhe Turqinë.

4. Objekti i Sigurimit

Siguruesi ofron mbulim për të gjitha mjetet motorike të klasifikuara si të tilla në aktet ligjore dhe nënligjore të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, lidhur me humbjen apo dëmtimin e plotë apo të pjesshëm të tyre si rezultat i rreziqeve të parashikuara në këto kushte sigurimi, në përputhje me përcaktimet e bëra në policën e sigurimit dhe kushtet e përgjithshme.

5. Mbulimet Bazë

5.1 Mbulimi "Përplasja, Përmbysja"

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet që i shkaktohen mjetit tuaj nga:

- a. Përplasja me një objekt fikse ose të lëvizshëm.
- b. Përmbysja e mjetit motorik.
- c. Rënia e objekteve nga lartësitë (shtylla, pemë, vazo, blloqe akulli etj)

Siguruesi, në rastin e ndodhjes së aksidentit dhe kur mjete është i pamundur teknikisht të lëvizë vetë, paguan shpenzimet e transportit për mjetin dhe personat që ndodhen në të, deri në vendmbërritje (brenda Shqipërisë) sipas çmimeve të tregut dhe distancës së lëvizjes sipas specifikimit të nenit 19 (pika i; j;k)

Transporti i mjetit në rast dëmi përfitohet vetëm kur mjete i dëmtuar nuk mund të vetëlëviz për shkak të dëmtimeve të cilat kanë kosto riparimi më të lartë se ajo e transportit të mjetit nga vendi i ngjarjes deri në vendbanim ose në servis ku do të kryhet riparimi i mjetit (në këto raste duhet të merret në konsideratë kryerja e një riparimi në servis ose vendin më të afërt me vendngjarje për rikthimin e mjetit në kushtet e vetëlëvizjes).

5.2 Mbulimi 2. “Zjarri, Eksplozioni dhe Rrufeja”

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj nga:

- a. Zjarri dhe Eksplozioni që vijnë nga **faktorë të jashtëm që vetëpërhapen dhe përfshijnë** mjetin e siguruar.
- b. Rrufeja direkt mbi mjetin motorik.

Nuk mbulohen:

- a. Çdo dëm që pëson mjete i siguruar, nga zjarri apo eksplozioni, që vijnë nga **shkaqe të brendshme të mjetit motorik dhe/ose nga defekte teknike të vetë mjetit**, objekt sigurimi.
- b. Çdo dëm që pëson mjete i siguruar, nga zjarri apo eksplozioni, ku shkak ka qenë pirja e duhanit brenda mjetit motorik.
- c. Dëmet e shkaktuara nga këto shkaqe (zjarr, eksplozion dhe rufeja), cilado qoftë natyra dhe origjina e tyre, nëse nuk është njoftuar në polici apo në repartin zjarrfikës.
- d. Dëmet e ndodhura nga eksplozivi apo lëndë të tjera plasëse të vendosura me qëllim në vetë objektin e siguruar.
- e. Dëme që vijnë si rezultat i konsumit normal të pjesëve dhe për shkak të mungesës të mirëmbajtjes së domosdoshme të mjetit.
- f. Nuk mbulohen rastet me pakujdesi të rënda nga drejtuesi i mjetit i cili qarkullon në rrugë me probleme të relievit si me gropa, rrugë të pashtuara ose pengesa sipërfaqësore të cilat neglizhohen; të cilat për shkak të kontakteve në pjesët e poshtme të mjetit shkaktajnë rritjen e fërkimit dhe me pjesët e jashtme të mjetit të cilat shkaktajnë vetëdëzje të pjesëve lehtësisht të djegshme. Gjithashtu përjashtohet rasti kur drejtuesi i mjetit për shkak të pakujdesisë së rëndë ose neglizhencës lëviz mjetin pa stakuar frenat e dorës.

5.3 Mbulimi “Rreziqe Natyrore”

Siguruesi do të paguajë të gjitha dëmet e mjetit tuaj, objekt sigurimi shkaktuar nga:

Stuhia, Breshëri, Dëbora, Orteqet, Tufani, Përmbytja, Vërshimi, të regjistruara dhe përcaktuara si rreziqe natyrore.

Siguruesi do të paguajë gjithashtu dhe dëmet e shkaktuara në mjetin tuaj nga rënia e objekteve të ndryshme, që ndodhin si pasojë e rreziqeve natyrore, ndërkohë që mjete është në qarkullim, pushim ose vendqëndrimin e tij.

Siguruesi do të paguajë edhe dëmet në mjetin tuaj shkaktuar nga përmbytja e garazhit si rezultat i çarjes së tubacioneve të ujrave edhe në rast se nuk ka ndodhur rrezik natyror.

Stuhi do të konsiderohet një çrregullim atmosferik me një lëvizje ajri me shpejtësi jo më të vogël se 17.2 m/s ose 62 km/ore e cila mund të shoqërohet me shira, dëborë ose rreshje të tjera.

Breshër do të konsiderohen rreshjet që formohen nga pikat e shiut të ngrira si akull në ajër dhe që bien kokrra – kokrra zakonisht në verë.

Dëborë do të konsiderohet rreshja atmosferike e ngurtë që bie flokë-flokë nga retë në trajtë kristalesh të bardhë me formë dhe përmasa të ndryshme.

Tufani do të konsiderohet era e vullshme zakonisht me shi të madh, breshër apo dëborë të dendur.

Përmbytje do të konsiderohet dalja e ujit nga kufijtë normal të rrjedhjeve natyrale apo artificiale, të liqeneve, rezervuarëve duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, digat dhe shpërndahet për shkak të rrymës së ujit me nivel të lartë si dhe vërshimi i ujit në rrugë për shkak të rreshjeve shumë të mëdha e të papritura.

Vërshimi është dalja e ujit të një lumi a përroi jashtë shtratit të tij i cili derdhet me vrull e përmbyt vendin rreth e rrotull.

Nuk Mbulohen:

- a. Dëmet e shkaktuara nga tërmeti dhe rrëshqitja e tokës.
- b. Dëmet e ndodhura gjatë kalimit të lumenjve ose pellgjeve dhe vendeve të përmbytura, etj

5.4 Mbulimi “Vjedhja” dhe “Tentativa për Vjedhje”

Vjedhje do të konsiderohet veprimi i përvetësimit në mënyrë të fshehtë, nga një ose disa persona, i mjetit motorik të siguar (vjedhje totale) ose i pjesëve apo aksesoreve të tij (vjedhje e pjesshme) ndërsa mjeti ishte i mbyllur më së miri në pushim ose vendqëndrimin e tij, me qëllim heqjen e kundraligjshme të pronësisë mbi mjetin e/të pronarit/ëve të ligjshëm.

Tentativë për vjedhje do të konsiderohet çdo veprim që ka synuar vjedhjen e mjetit motorik të siguar ose të pjesëve të tij, por që nuk ka mundur të kryhet, duke shkaktuar dëme ndaj mjetit motorik.

Është parakusht i këtij mbulimi që I Siguruari të deklarojë humbjen e çdo çelësi të mjetit tek Siguruesi, në të kundërt Siguruesi nuk mban përgjegjësi për demshperblimin e rastit të sigurimit.

Nuk Mbulohen:

- a. Dëmet nga vjedhja nëse ato janë kryer nga I Siguruari ose përdoruesit, nga punonjësit e shërbimit, ruajtjes apo të mbikqyrjes të vendit të punës apo parkimit.
- b. Dëmet nga vjedhja ose tentativë vjedhje kur nuk janë mbyllur mirë dyeret, tavani i lëvizshëm, xhamat ose çelësat e mbylljes janë lënë brënda mjetit, mbi ose përreth tij si dhe çdo rast tjetër kur mjeti rezulton i vjedhur me vetë çelësat e tij.
- c. Dëmet nga vjedhja e pjesshme me shkaqe të pashpjegueshme pa shenja dhune/dëmtimi e gjurmë të dukshme.
- d. Vjedhja e pajisjeve të tilla si antena, stema, kamera të jashtme, sensorë parkimi, **pasqyrat, goma**, përveç vjedhjes totale të mjetit motorik të siguar.
- e. Dëmi që rezulton të jetë shkaktuar nga vjedhja me dhunë ose tentativa e vjedhjes me dhunë, ndaj poseduesit të mjetit.
- f. Dëmi që rezulton të jetë shkaktuar nga vjedhja me armë ose tentativa e vjedhjes me armë, ndaj poseduesit të mjetit.
- g. Çdo dëm për humbje totale (vjedhje) kur nuk është denoncuar për ngjarjen në Organin kompetent të Policisë së Shtetit në mënyrë të menjëhershme.

5.5 Mbulimi “Thyerja e Xhamave”

Thyerje e xhamave do të kuptohet që nga plasaritja deri tek thërrmimi i xhamave të përparme, të prapme, anësorë, të tavaneve të levizshëm si dhe xhamave të fenereve të shkaktuara nga goditja e një objekti të levizshëm apo te palëvizshëm, duke shkaktuar ose jo dëme në vetë mjetin motorik.

Nuk Mbulohen:

- a. Dëmet e shkaktuara në mbulesat ose perdet mbrojtëse nga dielli.
- b. Dëmet në çdo xham tjetër që nuk përfshihet në katalogun e prodhimit, por që është vendosur në mjetin motorik dhe nuk kanë qenë të deklaruara në pyetësin e marrjes në sigurim.
- c. Dëmet e shkaktuara në xhama nga vjedhja ose tentativa për kryerjen e saj, përveç rastit kur mjeti është i mbuluar nga rreziku i vjedhjes.

I Siguruarit ka detyrimin të paraqesë foto në momentin e thyerjes së xhamit, në vendin e thyerjes së xhamit, ku të jetë i dokumentuar qartë në foto vendngjarja. Mosparaqitja e fotove i jep të drejtën Siguruesit të refuzojë dëmshpërblimin.

6. Mbulime shtesë

Me kërkesën e Të Siguruarit dhe miratimin e Siguruesit, I Siguruarit përkundër pagesës së primit mundet të mbulojë dëmin, shkatërrimin ose humbjen e mjetit nga veprimi ose ndodhja e secilit prej rreziqeve të mëposhtme. Këto mbulime janë të vlefshme vetëm nëse janë të shënuara në policën e sigurimit.

6.1 Aktet keqdashëse

Me anë të këtij mbulimi mjeti sigurohet prej dëmeve e shkatërrimeve nga aktet keqdashëse që pëson përgjatë lëvizjes, ndalimit apo qëndrimit në rrugë.

Akte keqdashëse sipas kësaj kontratë do të konsiderohen veprimet e dhunshme, të qëllimshme e të vullnetshme të individëve të motivuar nga dashakeqësia, që me zjarr, eksplozion ose mjete të tjera dëmtojnë ose shkatërrojnë mjetin objekt sigurimi.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim dëmet në mjet, të shkaktuara ose që rezultojnë nga:

- a. Veprimet e Të Siguruarit ose të nxitura e udhëzuara nga I Siguruarit, të afërmit ose punonjësit e tij;
- b. Lufta, lufta civile, rebelimi, revolucioni, kryengritja, puçi ushtarak, veprimet e fuqive ndërluftuese pavarësisht nëse lufta është deklaruar ose jo, aktet terroriste;
- c. Grevat (ndërprerja e punës), konfiskimi ose shkatërrimi i qëllimshëm i mjetit me urdhër të Autoritetit shtetëror, si dhe nga rrezatimi jonik ose ndotja radioaktive.
- d. Përrjashtohen ato raste kur i siguruarit nuk ka vënë në dijeni Të Siguruarin për rrezikun specifik që i kanosej për shkak të konflikteve të hapura para sigurimit për shkak të rrethanave të veçanta që ekzistojnë dhe kanë lidhje me Të Siguruarin, për të cilat ai ka qenë në dijeni.

6.2 Dëme në Parkim

Me anë të sigurimit të **Dëmeve në Parkim** do të kuptojmë mbulimin e dëmeve të shkaktuara mjetit që ndodhet i parkuar, në pjesët e jashtme të tij, që për nga natyra e tyre nuk mund të klasifikohen ndryshe përveç si veprime të rastësishme e të papërgjegjshme të kryera pa motiv e të paidentifikuar, përderisa nuk ka të dhëna që dëmi i shkaktuar mjetit lidhet, nxitet ose motivohet me personin e Siguruar, cilësitë, profesionin apo detyrën e tij.

Dëmtime të tilla përfshijnë, të gërvishturit me mjete të forta, njetosje apo shtypje të çdo pjesë të sipërfaqes së jashtme të mjetit.

Gjithashtu në këtë mbulim do të përfshihen të gjitha dëmet e ndodhura në mjetin objekt sigurimi nga goditjet e mjeteve të tjera që mbeten pa autor, përgjatë manovrimit për hyrjen ose daljen nga i njëjti garazh ose vend parkimi, me kusht që mjeti i dëmtuar të fotografohet në vendngjarje.

Siguruesi do të paguajë dëmet e shkaktuara në parkim deri në vlerën **50,000 lekë** në total për të gjitha rastet gjatë periudhës së sigurimit.

Nuk dëmshpërblehen nga ky mbulim: Dëme të shkaktuara nga vjedhja, vjedhja me dhunë ose armë, ose tentativa për kryerjen e veprimeve të tilla.

I siguruarit ka detyrimin të paraqesë foto në momentin e konstatimit të dëmit të mjetit të parkuar, pa e lëvizuar atë nga vendi i parkimit. Fotot duhet të paraqesin qartësisht mjetin e dëmtuar, dëmin që i është shkaktuar si dhe ambientin përreth tij. Fotot duhet të kenë të printuar dhe datën e ndodhjes së ngjarjes. Mosparaqitja e fotove i jep të drejtën Siguruesit ta refuzojë dëmshpërblimin për kërkesën e bërë.

6.3 Vjedhja me Dhunë ose Grabitja

Me termin “Vjedhje me dhunë” dhe “Grabitje” nënkuptojmë zhveshjen e Të Siguarit nga posedimi i mjetit me përdorimin e forcës, nën kërcënimin e jetës dhe shëndetit të zotëruesit të mjetit me cilësinë e të Siguarit, ndërsa mjete ishte në qarkullim.

Përdorimi i forcës dhe kërcënimin i jetës dhe shëndetit të drejtuesit të mjetit do të kuptojë gjithashtu përdorimin e armëve apo imitacioneve të tyre si edhe të mjeteve të tjera të dhunës të çfarëdo natyre, të afta që të parandalojnë qëndresën e reagimin e drejtuesit të mjetit ose të mos e mundesojnë atë.

Është kusht paraprak i këtij mbulimi që I Siguarit të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit për ngjarjen e ndodhur. Me termin menjëherë nënkuptojmë në çastin që I Siguarit, familjarët ose punonjësit e tij që ishin prezent (dëshmitarë të ngjarjes) ose morën dijeni për ngjarjen, kanë patur mundësinë të bënin këtë njoftim me mënyrën më të shpejte të mundshme, si telefonata etj.

7. Shërbime të tjera shtesë

Shërbimet e mëposhtme janë shërbime shtesë dhe mund të përzgjidhen individualisht ose të gjitha së bashku, përkundrejt pagesës së primit shtesë.

7.1 Paisja me GPS e mjetit të siguruar KASKO

Instalimi i pajisjes GPS në automjet për të marrë informacion mbi vendndodhjen e automjetit, intenerarin e përshkruar, kilometrat, orët e qëndrimit ndezur apo fikur. Shërbimi GPS do të ofrohet për mbulim brenda vendit ose për mbulim jashtë vendit. Kosto e GPS do të paguhet nga klienti. Pas përfundimit të kontratës pajisja do të rikthehet kompanisë që ofron këtë shërbim.

Përgjegjësia e instalimit dhe operimit të GPS është e kompanisë e cila e ofron këtë shërbim. Kompania e Sigurimit ka detyrimin të njoftojë Klientin për të dhënat dhe kontaktet e kompanisë së GPS.

7.2 Vendosi në dispozicion të të Siguarit të një mjeti me qera deri në riparimin e mjetit të dëmtuar, për një periudhë maksimale deri në 14 ditë dhe me një vlerë maksimale deri në 40,000 All. Klienti duhet të paraqesë fature për shpenzimet shoqëruar me kontratën e qerasë dhe mjeti i dëmtuar duhet të riparohet në servis të autorizuar nga Siguruesi. Mjeti mund të vihet në dispozicion nga Siguruesi për Të Siguarin, nëse dakortësohet më pare.

7.3 Karrotrec

Siguruesi do të kompensojë Të Siguarin për shërbimin karrotrec në rast të pamundësisë së lëvizjes së mjetit motorrik (si pasojë e defektit, etj dhe që nuk ka të bëjë me aksidente rrugore) deri në vlerën 50,000 All në total për të gjithë periudhën e sigurimit. Ky mbulim do të ofrohet me tarifë ekstra e cila do të paguhet nga I Siguarit.

8. Përjashtimet e Përgjithshme

Nuk janë të mbuluara dëmet apo humbjet në mjetin e siguruar që përcaktohen, shkaktohen ose që rezultojnë nga:

- a. Vlera e pjesës së zbritshme e shënuar në policën e sigurimit
- b. Dëmet e shkaktuara qëllimisht dhe / ose të udhëzuara nga personi i Siguarit dhe/ose prdoruesi.
- c. Dëmet që rezultojnë nga çdo akt i luftës, invazionit, veprimeve të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile, turbullira civile, revolucione, lëvizja separatiste, kryengritja popullore, rebelimit, revolta, puce, grushte shteti, eksode, akteve terroriste, trazirave, grevës, sabotimit.
- d. Dëmet që vijnë si rezultat i shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor, ndotjes radioaktive, rrezatimeve jonizuese, ndotjeve kimike.
- e. Dëmet në mjetin e siguruar, të bllokuar ose në tentativë bllokimi nga Organet e Shtetit.

- f. Dëmet që shkaktohen nga përdorues, emrat e cilëve nuk janë shënuar në kontratën e sigurimit, përveç familjareve që kanë emrin në certifikatën familjare. Në rastet e kompanive, punonjësi ose përdoruesi i mjetit duhet të ketë autorizim të vlefshëm në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.
- g. Dëmet që rezultojnë nga konsumi normal, defektet apo avaritë e brendshme elektrike apo mekanike gjatë ndezjes ose lëvizjes së mjetit.
- h. Dëme ose pjesë të dëmtuara të cilat janë të dëmtuara që në momentin e marrjes në sigurim dhe që janë të vërtetuara nga fotot e marrjes në sigurim që kanë qenë të dëmtuara.
- i. Dëme të ndodhura gjatë nisjes apo gjatë lëvizjes së mjetit, si pasojë e lënies së dyerve, bagazhit apo kofanos hapur.
- j. Dëme ose pjesë të dëmtuara të cilat janë të dëmshpërblyer njëherë nga Siguruesi dhe që nuk janë zëvendësuar. Barra e provës e zëvendësimit të tyre bie mbi të Siguruarin, në momentin kur ky i fundit ka përfituar shumën përkatëse nga Siguruesi.
- k. Humbjet financiare të çdo lloji të shkaktuara nga mospërdorimi i mjetit motorik.
- l. Qarkullimi i mjetit në rrugë të pa inventarizuara dhe që nuk janë të destinuara për qarkullimin e mjeteve.
- m. Prerja apo skopjimi i gomave, por jo dëmet pasuese që rrjedhin prej këtij shkakut ose objekti.
- n. Përrjashtohen dëmtimet, gërvishtjet e disqeve apo gomave gjatë parkimit të mjetit.
- o. Dëmet në mjetin motorik të siguruar në operacione të tilla si, shërbimi i servisit, furnizimi me karburant kur dëmi shkaktohet si pasojë e furnizimit apo gjatë tij, transporti me karrotrec, riparimi i mjetit, kontrolli teknik, larja, dorëzimi ose shitja, që nënkuptojnë se mjeti është në zotërim dhe mbi të kryhen veprime nga persona të tretë të ndryshëm nga i Siguruarin, të cilët mbahen përgjegjës për çdo dëm që i ndodh mjetit, për sa kohë mjeti është në zotërimin e tyre;
- p. Dëmet e shkaktuara kur drejtuesi i mjetit ndodhet nën ndikimin e efekteve të alkoolit e të drogës ose refuzon t'i nënshtrohet provave të këtij kontrolli.
- q. Dëmet e shkaktuara në mjet nga transportimi i lëndëve radioaktive, eksplozive, gërryese, ndezëse, jonizuese etj.
- r. Shkelja e normave të qarkullimit rrugor e klasifikuar "pakujdesi e rëndë", për të cilat Kodi Rrugor parashikon tërheqjen e lejes së drejtimit për drejtuesin e mjetit
- s. Mosvendosja e zinxhirëve të dëborës në kushte moti të cilat detyronin drejtuesin e mjetit që ti vendoste ato.
- t. Qarkullimi i mjeteve me defekte teknike, kur drejtuesi i mjetit kishte dijeni ose duhej të kishte dijeni për to si dhe kur mjeti nuk ka certifikatë kontrolli teknik vjetor të vlefshëm në momentin e aksidentit;
- u. Drejtuesi nuk e përdor mjetin në përputhje me qëllimin për të cilin ai është i destinuar të përdoret, nuk ka leje të vlefshme të drejtimit të mjetit motorik sipas kategorisë apo tipit të mjetit, i është tërhequr ose pezulluar nga autoriteti kompetent leja e drejtimit të mjetit në momentin që ndodh ngjarja e sigurimit, apo i ndalohet përdorimi i lejes së drejtimit të lëshuar nga një shtet tjetër, për territorin e Republikës së Shqipërisë;
- v. Dëmet ose humbjet e objekteve, sendeve personale, mallrave ose bagazheve që ndodhen në mjet në momentin e rastit të sigurimit.
- w. Siguruesi s'do të mbulojë zmadhimin e humbjeve ose dëmeve për shkak të neglizhencës të Të Siguruarit ose mosmarrjes së masave parandaluese që të mos thellohen ato. Siguruesi do të paguajë shpenzimet e arsyeshme të bëra që nuk lejojnë që të zmadhohen dëmet ose humbjet.
- x. Përfshirja e mjetit në një aksident automobilistik për të cilin I Siguruarin ka përfituar ose përfiton ligjrisht dëmshpërblim nga sigurimi i detyrueshëm;
- y. Mosplotësimi i kushteve të marrjes në sigurim si:
- Mosplotësimi dhe nënshkrimi i pyetësorit të marrjes në sigurim;
 - Nëse konstatohen pasaktësi në plotësimin e pyetësorit dhe në deklaratimet përkatëse
 - Moskryerja e fotove në momentin e marrjes në sigurim (minimumi 4 foto që tregojnë të gjithë pjesët e mjetit)

9. Kontrata e Sigurimit

9.1 **Kërkesa për Sigurim.** Kupton kërkesën e Të Siguruarit për sigurimin e mjetit të tij duke i dhënë përgjigje formularit standart të përgatitur nga Siguruesi. I Siguruarin ose personi i autorizuar nga ai, nënshkruan së bashku me agjentin ose specialistin e marrjes në sigurim kërkesën për sigurim dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e deklaratimeve të bëra në të. Pas plotësimit të kërkesës për sigurim, I Siguruarin nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut pa miratimin me shkrim Të Siguruesit. Me shtim të rrezikut

kuptohen rrethanat që janë thelbësore të cilat mund të influencojnë në vendimin e Siguruesit për të lidhur ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë.

Në rast të moszbatimit të kushteve të mësipërme, Siguruesi çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

9.2 Lidhja e Kontratës. Kontrata e Sigurimit hyn në fuqi në orën 24.00 të datës së fillimit të shkruar në policën e sigurimit me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit ose këstet sipas afateve të parashikuara në marrëveshje, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe.

Kontrata e Sigurimit përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, natyrën dhe shtrirjen e mbulimeve si dhe ndryshimet e primeve që rezultojnë nga ndryshimi i faktorëve të rrezikut. Ajo nënshkruhet nga të dy palët, Siguruesi dhe I Siguruari ose personat e autorizuar prej tyre.

9.3 Kalimi i të Drejtave. Të drejtat dhe detyrat e Të Siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në Kontratën e Sigurimit. Në rast se I Siguruari vdes, mbulimi për mjetin e siguruar do të vazhdojë të aplikohet për trashëgimtarët ligjorë ose përfaqësuesin zyrtar tek të cilët kalojnë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë për përdorimin e mjetit, deri në fund të periudhës së sigurimit.

9.4 Zgjidhja. Kontrata mund të zgjidhet pas njoftimit me shkrim të secilës palë që e dëshiron këtë duke treguar datën e zgjidhjes së kontratës.

Siguruesi do të zgjidhë kontratën e sigurimit në qoftë se:

- a. Nuk është paguar kësti vijues i primit të sigurimit, ose primi i sigurimit për kontratat e rinovuara. Data e zgjidhjes do të jetë 15 ditë pas mbarimit të afatit të pagimit. Siguruesi nuk është përgjegjës për humbje ose dëme të ndodhura gjatë periudhës 15 ditore.
- b. Ka të dhëna për pasaktësi të informacionit të dhënë nga I Siguruari.
- c. Kur I Siguruari ka më shumë se tre dëme gjatë periudhës së sigurimit, me përjashtim kur është rënë dakort ndryshe.

I Siguruari mund ta zgjidhë Kontratën:

- a. Duke njoftuar 30 ditë përpara datën e zgjidhjes.
- b. Me paraqitjen e certifikates së çregjistrimit të mjetit motorik. Në këtë rast zgjidhja e kontratës bëhet brenda 5 ditëve.

Kthimi i primit kur zgjidhja ndodh nga Siguruesi apo I Siguruari do të jetë proporcional me pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit, pasi të jenë zbritur komisioni për pjesën e primit të kthyer si dhe shpenzimet administrative fikse në masën (500 lekë ose 4 Euro).

Nuk bëhet kthim primi për pjesën e mbetur të periudhës së sigurimit:

- Nëse I Siguruari ka përfitur ose mund të përfitojë dëmshpërblim nga kjo kontratë
- Kur ka konsumuar 9 muaj periudhën e sigurimit

9.5 Mbarimi.

- Kontrata mbaron automatikisht në fund të periudhës së sigurimit.

- Kontrata mbaron në ditën e rastit të sigurimit si rezultat i të cilit mjeti motorik i siguruar është dëmtuar totalisht ose është vjedhur. Në këtë rast primi i sigurimit nuk kthehet.

10. Shuma e Siguruar

Çdo mjet motorik sigurohet për t'u mbuluar nga rreziqet deri në një vlef të caktuar, kundrejt së cilës llogaritet dhe primi i sigurimit dhe quhet shuma e siguruar. Shuma e siguruar e mjetit objekt sigurimi përcaktohet me

marrëveshje mes palëve të interesuara, duke u bazuar si rregull, në vlerën e zëvendësimit, vlerën e tregut të mjetit, ose faturën e blerjes sipas përcaktimeve me poshtë.

- **Me vlerë zëvendësimi** do të kuptojmë shumën më të vogël të parave të mjaftueshme për blerjen e të njëjtit mjet (kategori, markë, model, kapacitet) si të ri, duke i zbritur vlerën e humbur ose amortizimin për shkak të vjetërsisë. Amortizimi për vjetërsi llogaritet 20% të vlerës së mjetit për vitin e parë dhe deri në 10 % për çdo vit që pason.
- **Vlera e tregut** përcaktohet duke ju referuar "Manualit" në fuqi (si quattuoruote) të përdorur nga Entet e specializuara dhe/ose shoqëritë e sigurimit për vlerat orientuese të mjeteve motorike të përdorura, si dhe çmimit të tregut të mjeteve të përdorura në Republikën e Shqipërisë, për të njëjten kategori dhe model mjeti.
- Fatura e blerjes është fatura e lëshuar nga dyqanet e specializura (koncesionari) për shitjen e automjeteve.

Si rregull shuma e siguruar përcaktohet nga vlera më e ulët e referencave si më sipër.

Rivendosja e Shumës së Siguruar

Mbas pagesës së dëmit shuma e siguruar mund të rivendoset në vlerën e saj fillestare në rast se I siguruari paguan prim shtesë.

Në rast se I Siguruari nuk paguan prim shtesë pra nuk e rivendos shumën e siguruar, atëherë mjeti motorik qendron i siguruar deri në fund të afatit të caktuar në policën e sigurimit kasko për një shumë sigurimi të barabartë me diferencën e shumës të sigurimit fillestare dhe vlerës të dëmshpërblimit të përfituar.

a. Për mjetet e reja.

Shuma e sigurimit për mjetet e reja: Mjete të tilla do të konsiderohen ato që në momentin e marrjes në sigurim kanë jo më shumë se 10,000 km, ose që nuk janë me të vjetra se 4 (katër) vjet nga dalja e tyre si të reja (km 0) në qarkullim.

Shuma e sigurimit për mjete të reja përcaktohet nga vlera e zëvendësimit që përlllogaritet nga vlera e faturës së paguar nga blerësi në kompaninë shitëse të specializuar, në të cilën janë ose mund të përfshihen edhe detyrimet doganore si edhe shpenzimet e tjera ligjore të nevojshme për daljen e mjetit në qarkullim, minus zhvlerësimin për vjetërsi.

b. Për mjetet e përdorura brenda garancisë.

Shuma e sigurimit për mjetet e përdorura: Do të konsiderohen të tilla sipas kësaj kontratë të gjitha mjetet që janë jo më shumë se 4 vjet nga viti i Prodhimit. Shuma e Sigurimit e tyre do të përcaktohet nga tregu ose nga amortizimi i vlerës për vitin e parë me 20% dhe për vitet e tjera me 5% në vit.

Shuma e siguruar vendoset në kontratën e sigurimit.

c. Për mjetet e përdorura

Do të konsiderohen të tilla sipas kësaj kontratë të gjitha mjetet që janë më shumë se 4 vjet, por jo më shumë se 10 vjet të vjetra në qarkullim, në momentin e marrjes në sigurim. Shuma e siguruar zgjidhet sipas vleftës së mjetit në treg në momentin e marrjes në sigurim.

11. Pjesa e Zbritshme, Franshiza

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshizë.

Për çdo rast dëmi Siguruesi do të zbrisë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Kontratën e Sigurimit në shumë absolute ose në përqindje. Siguruesi nuk do të paguajë dëme të veçanta që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në Kontratën e Sigurimit.

Masa e pjesës së zbritshme dhe franshizës vendoset në Kontratën e Sigurimit.

12. Tarifa dhe Primi i Sigurimit

Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në bazë të llogaritjeve sipas mbulimit të zgjedhur, klasifikimit dhe veçorive të mjetit motorik dhe vendoset në kontratën e sigurimit.

I Siguruari është i detyruar t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumës dhe afateve të përcaktuar në kontratë. Paga e primit do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë e Siguruesit.

13. Sigurime të tjera

a. Nëse I Siguruari kryen një ose disa sigurime të tjera të mjetit, ai duhet t'i njoftojë **menjëherë** me shkrim Siguruesit, emrin e Siguruesit/sve të tjerë dhe shumat e siguruara respektive.

Kur I Siguruari me dashje ose për shkak të pakujdesisë nuk plotëson detyrimet e mësipërme, atëherë Siguruesi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit, mospagimit të dëmshpërblimit dhe mbajtjen e primit të sigurimit.

b. Nëse në momentin e ndodhjes së një dëmi, sipas kësaj kontratë ekzistojnë sigurime të tjera, të cilat mbulojnë të njëjtin dëm, masa e dëmshpërblimit që përfiton i Siguruari nga të gjitha kontratat e sigurimit nuk mund të jetë më e lartë sesa masa e dëmit minus pjesën e zbritshme. Pjesa e dëmit që paguajnë Siguruesit është propocionale me shumat e siguruara.

c. Nëse I Siguruari kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme. Siguruesi mban primin e sigurimit dhe I Siguruari humbet të drejtën e dëmshpërblimit.

14. Mbisigurimi

a. Nëse shuma e siguruar e tejkalon me mbi 15% vlerën e mjetit motorik ne treg, atëherë Siguruesi mund të kërkojë zvogëlimin e shumës së siguruar dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht.

b. Nëse I Siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme dhe I Siguruari humbet të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

15. Nën sigurimi

Nëse në momentin menjëherë pas ndodhjes së rastit të sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e mjetit motorik, dëmshpërblimi i llogaritur do të shumëzohet me koeficientin e nën sigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së mjetit objekt sigurimi.

16. Njoftimi i Rastit të Sigurimit.

I Siguruari ose përfaqësuesi ligjor i tij, që kërkon të dëmshpërblehet për dëmet në mjetin motorik të siguruar, është i detyruar që menjëherë të njoftojë rastin e sigurimit së bashku me raportin e organeve kompetente zyrtare.

Sipas kësaj kontratë me një ngjarje sigurimi do të kuptojmë, përfshirjen e mjetit në një aksident ose ngjarje automobilistike në rrugë ose fatkeqësi natyrore, përfshirë vjedhjen, pasojat e të cilit rezultojnë në një dëm ose seri dëmsh në mjetin objekt sigurimi dhe janë rrjedhojë e një shkakut dhe/ose shkaqeve të identifikueshëm e mbulueshëm nga kjo kontratë, të cilët veprojnë pa ndërprerje njëri pas tjetrit derisa përfundojnë.

Dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar ngjarjen e sigurimit, duhet të përmbajë :

a. Formularin standart të Njoftimit të Rastit të Sigurimit, i përgatitur më parë nga Siguruesi të plotësuar me besnikëri në të gjitha rubrikat e tij, pa shtrembërime të fakteve të rastit të sigurimit nga I Siguruari.

Njoftimi i rastit të sigurimit duhet të bëhet ne forme te shkruar (poste, email, sms) brenda **48 orëve** nga momenti i ndodhjes së aksidentit pranë Departamentit te Demeve, degëve ose zyrave qendrore të INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP.

- b. Foto të aksidentit në vendin e ngjarjes
- c. Raportin e Policisë Rrugore, në rastin e mbulimit 1, Përplasje dhe Përmbysje, përfshi rastet e daljes jashtë rrugës apo humbjes së kontrollit, e cila njoftohet nga I Siguruari dhe merret raporti për ngjarjen.
- d. Raportin e Shërbimit të MNZ (mbrojtjes nga zjarri), në rastin e mbulimit 2, “Zjarri, eksplozioni, rrufeja”, shërbim i cili njoftohet menjëherë nga I Siguruari. Kompania ka të drejtë të pezullojë trajtimin e dëmit deri në plotësimin e dokumentacionit përkatës nga Prokuroria.
- e. Raportin e Autoritetit përkatës shtetëror në rastin e mbulimit 3, “Rreziqe natyrore”.
- f. Vërtetimin e njoftimit në Komisariatit e Policisë në rastin e mbulimit 4 “Vjedhja”, mbulimet shtesë 6.1 “Aktet Keqdashëse” dhe 6.3 “Vjedhja me dhunë” ose “Grabitja”, njoftim i cili duhet të jetë bërë nga I Siguruari brenda 24 orëve nga konstatimi i ndodhjes së ngjarjes. Në rastet e “Vjedhjes totale” ose “Grabitjes” duhet të paraqitet gjithashtu edhe Vendimi i Prokurorisë për fillimin e çështjes penale.
- g. Kopja që dëshmon për lajmërimin dhe denoncimin pranë organeve kompetente zyrtare, i vihet në dispozicion Siguruesit së bashku me Njoftimin e Rastit të Sigurimit jo më vonë se 48 orë nga momenti i ngjarjes.

Mosplotësimi i një ose disa prej dokumentave të mësipërme i jep Siguruesit të drejtë të çlirohet nga detyrimet për pagesën e dëmit.

17. Vlerësimi i Dëmit

I Siguruari për dëmet në mjetin e siguruar, paraqet kërkesën për dëmshpërblim brenda afateve të parashikuara nga kushtet e kesaj kontratë, vetëm pasi ka bërë njoftimin e rastit të sigurimit nëpërmjet formularit standart.

- a. Kërkesa për dëmshpërblim i drejtohet Departamentit te Demeve, degëve ose zyrave qendrore të INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP. I Siguruari është i detyruar të paraqesë kur i kërkohe të gjitha dokumentat e nevojshme që kanë lidhje me rastin e sigurimit.
- b. Siguruesi gëzon të drejtën për të verifikuar vërtetësinë e rastit të sigurimit si dhe të madhësisë së dëmit. Brenda 10 ditëve nga momenti që është njoftuar për rastin e sigurimit, Siguruesi përfundon ekspertimet e nevojshme, ndërsa mjeti mbahet pa u riparuar nga i Siguruari gjatë kësaj periudhe.
- c. Vlerësimi i dëmit duhet të jetë brenda Limitit të Përgjegjësisë dhe vlerës së tregut të mjetit të dëmtuar
- d. Në rast mosmarrëveshje, por vetëm pasi Siguruesi ka ofruar vlerësimin e tij, të dy palët krijojnë një komision arbitrazhi të paanshëm, me pjesëmarrjen e ekspertëve të secilës palë dhe të një eksperti të tretë. Shpenzimet e këtij komisioni përcaktohen në momentin e krijimit të tij nga palët.
- e. Në qoftë se ndodh rasti i sigurimit (dëmtim total apo vjedhje e plotë), Siguruesi ka të drejtën e zëvendësimit të mjetit të dëmtuar me një mjet tjetër i së njëjtës markë e model. Pjesa e zbritshme në këto raste do të jetë **20% e vlerës së mjetit**. Nëse për mjetin është paguar një ose disa dëme të tjetër paraprakisht, vlera e pagesave të realizuara paraprakisht do i zbritet vlerës së dëmshpërblimit.

18. Limiti i Përgjegjësisë

Limiti i përgjegjësisë për dëmet në mjetin e siguruar është:

- a. Vlera e nevojshme për riparimin e mjetit të dëmtuar ose shumën në CASH për të zëvendësuar dëmin sipas vlerës së tregut në Shqipëri në momentin e ndodhjes së dëmit por jo më shumë se shuma e siguruar.
- b. Vlera e mjetit të vjedhur ose dëmtuar totalisht sipas vlerës së tregut në Shqipëri në momentin e ndodhjes së dëmit, por jo më shumë se shuma e siguruar.

Pjesët që mbeten të padëmtuara do të zbriten nga vlera aktuale. Vlerësimi i këtyre pjesëve është i ngjashëm me vlerësimin e dëmit. Siguruesi nuk është i detyruar të mbajë pjesët e mbetura të padëmtuara, përveç rasteve kur bihet dakord midis palëve.

19. Pagesa e Dëmit

Siguruesi do të paguajë përfituesin ose trashëgimtarin ligjor të tij për dëmet në mjetin motorik të siguruar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në kontratën e sigurimit. Dëmet me vlerë më të vogël se **Franshiza** e përcaktuar në kontratë, **nuk paguhen** përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe

- a. Siguruesi do të paguajë dëmet brenda 30 ditëve pas dorëzimit të dokumentave të nevojshme të kërkuara prej tij.

- b. Në qoftë se mjeti është përfshirë në një rast sigurimi të vjedhjes, Siguruesi pas 60 ditëve nga plotesimi i dokumentacionit duhet të parapaguajë një pjesë të dëmshpërblimit deri në 60% të limitit të përgjegjësisë.
- c. I Siguruari do të njoftojë brenda 60 ditëve nga ndodhja e rastit të sigurimit neqoftese mjeti i vjedhur do të gjendet. Në rast se nuk është bërë parapagimi, mjeti motorik i gjetur do të vihet në dispozicion të të Siguararit, ndërsa Siguruesi paguan dëmet që mund të rezultojnë dhe që janë të mbuluara në sigurim.
- d. Në rast se është bërë parapagimi nga Siguruesi, mjeti motorik i gjetur duhet të vihet në dispozicion të tij, ndërsa të Siguararit do t'i paguhet pjesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer parapagimin e bërë nga Siguruesi duke reduktuar nga kjo pagesat për dëmet që mund të rezultojnë.
- e. Pjesa e papaguar deri në limitin e përgjegjësisë duke zbritur pjesën e zbritshme duhet paguar kur të gjitha procedurat investiguese janë mbyllur, por jo më shumë se 180 ditë.
- f. Në rast se është bërë dëmshpërblimi deri në limitin e përgjegjësisë dhe mjeti gjendet, I Siguruari ka detyrimin ta vendos mjetin në dispozicion të Siguruesit. I Siguruari ka të drejtë të marrë mjetin duke kthyer pagesën që i është bërë duke reduktuar nga kjo pagesat për dëmet që mund të rezultojnë.
- g. Në rast se I Siguruari nuk është dakord me dëmshpërblimin e ofruar, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit nga Siguruesi, duhet të paraqesë refuzimin me shkrim duke paraqitur argumentat përkatëse.
- h. Në rast se I Siguruari ka bërë deklaratë të rremë, është implikuar në veprime mashtrimi duke përvetësuar me të padrejtë një dëmshpërblim, Siguruesi ka të gjitha të drejtat për të kërkuar kthimin e plotë të dëmshpërblimit të paguar plus shpenzimet e tjera që lidhen me rastin.
- i. Siguruesi paguan deri në **30,000 Lekë** gjithsej për shpenzimet e transportit dhe të ngarkim-shkarkimit të mjetit të dëmtuar që nuk vetëlëviz si pasojë e aksidentit, deri në vendqëndrim ose në pikën e servisit të rënë dakord mes palëve, pa u përsëritur kjo rrugë.
- j. Siguruesi paguan shpenzimet e Të Siguararit dhe pasagjerëve që ndodheshin në mjetin e dëmtuar, për vazhdimin e udhëtimit për mbërritjen në destinacionin e paracaktuar ose në vendin e nisjes, brenda territorit të Republikës Shqiptare, me një mjet tjetër deri në **2,000 Lekë** për një person.
- k. Siguruesi paguan shpenzimet e ruajtjes së mjetit të dëmtuar që nuk vetëlëviz, nga momenti i rastit të sigurimit deri në përfundim të ekspertizës së nevojshme, por jo më shumë se **5,000 Lekë** gjithsej.

20. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe Të Siguararit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.